


Ndryshimet në legjislacion

Mars 2017

Në këtë publikim:

- Udhëzim Administrativ Nr. 01/2017 për Promovimin e Investimeve të Përbashkëta Rajonale në Sektorin e Energjisë;
- Udhëzim Administrativ Nr. 02/2017 për Kompetencat, Mandatin dhe Punën e Komisionit të Ankesave në Agjencinë për Pronësi Industriale;
- Rregullore Nr. 02/2017 për Mbrojtjen e të Punësuarve nga Rreziqet lidhur me Zhurmën në Vendin e Punës;
- Rregullore Nr. 01/2017 për Mbrojtjen e të Punësuarve nga rreziqet lidhur me Dridhjen në Vendin e Punës;



I. Udhëzim Administrativ Nr. 01/2017 për Promovimin e Investimeve të Përbashkëta Rajonale në Sektorin e Energjisë

Ky Udhëzim Administrativ u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 8 Mars 2017, ka hyrë në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është promovimi i investimeve të përbashkëta rajonale në sektorin e energjisë, identifikimi i projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë në infrastrukturë të energjisë elektrike, gazit dhe naftës, si dhe bashkërendimi i aktiviteteve në lëshimin e lejeve.

Ky Udhëzim Administrativ është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në udhëzimet për Infrastrukturën Energjetike Trans-Evropiane, për shfuqizimin e Vendimit nr. 1364/2006/EC, si dhe për ndryshimin e Rregulloreve (EC) nr. 713/2009, (EC) Nr. 714/2009 dhe (EC) Nr. 715/2009, të inkorporuara dhe përshtatura me Vendimin e Këshillit të Ministrave 2015/09/MC-EnC, të datës 16 tetor 2015 për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi Udhëzimet për Infrastrukturën Energjetike Trans-Evropiane.

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ vlejné për të gjitha projektet me interes për Komunitetin e Energjisë, në kategoritë e infrastrukturës së energjisë elektrike, gazit dhe naftës.

Ministri me Vendim cakton Autoritetin Kompetent për bashkërendimin e aktiviteteve në lëshimin e lejeve, për projektet me interes

për Komunitetin e Energjisë, si dhe këtë ia komunikon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, deri më 30 Qershor 2017. Detyrat dhe përgjegjësit e Autoritetit Kompetent janë të përshkruara në këtë Udhëzim Administrativ.

Ministria në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mjedis dhe planifikimit hapësinor si dhe me autoritetet tjera përkatëse analizon dhe vlerëson se cilat masa janë të mundshme për harmonizimin e procedurave shtetërore të vlerësimit mjedisor, në bazë të udhëzimeve të nxjerra nga Komisioni Evropian, si dhe informon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë mbi rezultatet.

Ky Udhëzim Administrativ ka dy (2) shtojca të cilat janë pjesë përbërëse të këtij Udhëzimi Administrativ.

II. Udhëzim Administrativ Nr. 02/2017 Për Kompetencat, Mandatin dhe Punën e Komisionit të Ankesave në Agjencinë për Pronësi Industriale

Ky Udhëzim Administrativ u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 22 Mars 2017, dhe ka hyrë në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi dhe rregullimi i procedurave të punës së Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve kundër vendimeve të marra nga Agjencia për Pronësi Industriale gjatë procedurave të regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale.

Ky udhëzim administrativ zbatohet në çdo rast kur palët paraqesin ankesë kundër vendimeve të Agjencisë së Pronësisë Industriale (API).

Ky udhëzim administrativ parasheh që me një vendim të Ministrit të themelohet komisioni i përbërë nga tre anëtarë dhe është përgjegjës për shqyrtimin dhe vendosjen e të gjitha ankesave të parashtruara nga palët kundër vendimeve të API-së.

Sipas këtij udhëzimi administrativ, ankesa duhet të përmbajë disa detaje specifike dhe Komisioni pas shqyrtimit të ankesës, merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Kundër vendimeve të API-së të nxjerra në shkallë të parë, pala e interesuar ka të drejtë

ankese në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Nëse Komisioni nuk vendos në afatin e caktuar ose kthen përgjigje me të cilën pala është e pakënaqur, pala mund të iniciojë kontest administrativ në Gjykatën Themelore, brenda 30 ditësh.

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2012 për Kompetenca, Mandatin dhe Punën e Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Pronësisë Industriale.

III. Rregullore Nr. 02/2017 Për Mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet lidhur me zhurmën në vendin e punës

Kjo rregullore u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 3 Mars 2017, dhe ka hyrë në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

Kjo Rregullore përcakton kërkesat minimale të nevojshme për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet për sigurinë dhe shëndetin në punë, të cilat krijohen ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj zhurmës në vende të punës, dhe në veçanti riskun për dëmtimin e dëgjimit.

Kjo Rregullore është në përputhshmëri me Direktivën 2003/10/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 6 shkurt 2003 për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë lidhur me ekspozimin e punonjësve ndaj risqeve që krijohen nga agjentët fizik zhurma, (Direktiva e shtatëmbëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 98/391/KEE).

Kërkesat e kësaj Rregulloreje zbatohen për veprimtaritë në punë në të cilat të punësuarit janë ose mund të ekspozohen ndaj rreziqeve nga zhurma. Dispozitat e kësaj rregulloreje do të aplikohen nga të gjitha vendet e punës të cilat janë brenda fushës së veprimit të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Siç kërkohet nga Ligji i lartpërmendur, kjo rregullore parasheh që punëdhënësi siguron kryerjen e vlerësimit të riskut, ku identifikohen masat që duhen marrë dhe nëse është e nevojshme siguron gjithashtu kryerjen e matjeve të nivelit të zhurmës në vendin e punës.

Sipas kësaj rregullore, vlerësimi i riskut kryhet si në vijim:

- Të paktën njëherë në dy vite nëse vlerësimi i riskut tregon që vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit janë arritur,
- Të paktën njëherë në vit, nëse vlerësimi i riskut tregon se vlerat e sipërme të ekspozimit janë arritur.

Ekspozimi i të punësuarve nuk lejohet të kalojë vlerat kufitare. Nëse rreziqet që krijohen nga ekspozimi ndaj zhurmës nuk mund të parandalohen me metoda dhe mjete tjera, punëdhënësi do të vë në dispozicion pajisje mbrojtëse personale të dëgjimit të përshtatshme sipas përmasave të duhura.

Gjithashtu trajnim dhe mbikëqyrje shëndetësore do të bëhen.

Kjo rregullore ka dhe dy shtojca që janë pjesë përbërëse të saj.

IV. Rregullore Nr. 01/2017 Për Mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet lidhur me dridhjen në vendin e punës

Kjo rregullore u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 3 Mars 2017, dhe do të hyj në fuqi 7 ditë pasi të nënshkruhet nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet për sigurinë dhe shëndetin që krijohen ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj dridhjes mekanike.

Kjo rregullore është në përputhje me Direktivën 2002/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002, për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që krijohen nga agjentët fizikë (dridhjet) (direktiva e gjashtëmbëdhjetë individuale në kuptim të nenit 16(1) të Direktivës 89/391/KEE).

Dispozitat e kësaj Rregulloreje do të zbatohen për vendet e punës dhe veprimtarisë në të cilat të punësuarit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen ndaj rrezikut nga dridhjet mekanike gjatë punës së tyre. Kjo rregullore do të zbatohet për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në punë.

Në bazë të kësaj rregullore, vlerësimi i riskut kryhet nga shërbimet të specializuara në intervalet si mëposhtë:

- Çdo vit nëse vlerësimi i riskut tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit e kanë arritur vlerën referente;
- Çdo dy vjet nëse vlerësimi i riskut tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit nuk janë arritur dhe 1/5 e vlerës kufitare të ekspozimit është tejkaluar.

Dispozitat e kësaj rregullore parashohin që, punëdhënësi duhet të ndërmarrë masat e nevojshme që rreziku nga ekspozimi i të punësuarve ndaj dridhjes të eliminohet në burim dhe kur kjo nuk është e mundur, risku duhet të zvogëlohet në minimum.

Punëdhënësi siguron që të punësuarit të ekspozuar ndaj risqeve të dridhjes mekanike në punë si dhe përfaqësuesit e tyre të marrin informacion dhe trajnim të mjaftueshëm.

Gjithashtu punëdhënësi do të merr masa për kryerjen e mbikëqyrjes shëndetësore të të punësuarve për të cilët vlerësimi i riskut që paraqet rrezik për shëndetin nga dridhja në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën përkatëse për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore.

Kjo rregullore përmban 4 shtojca, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e rregullores.

Kontaktet e Deloitte:

Afrore Rudi

Drejtoreshë | Shërbime Tatimore dhe Ligjore
Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Ali Hadri n.n., 10000

Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob: +386 (0)49 590 807

Email: arudi@deloittece.com

Luljeta Plakolli - Kasumi

Menaxhere | Shërbime Ligjore
Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Ali Hadri n.n., 10000

Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob: +386 (0)49 780 769

Email: lpakollikasumi@deloittece.com

Përrjashtim i përgjegjësisë:

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim i shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të i ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet i rrjetit të Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën www.deloitte.al/about.

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në sajë të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhënë njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.

© 2017 Deloitte Kosova sh.p.k